



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Priljevoj / Prilato Received / Delivered	28.06.2021	1	viti god year
Organ dëgjues Organ / Jedinitca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSBICK	3326/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.418/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.418/2021, të datës 14.05.2021, të parashtruara nga ankuesja me adresë banimi Lagjja Ulpiana , D6, hyrja Nr. 65/6, Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*Kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.418/2021 e datës 14.05.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 14.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2393/2021 të regjistruar me A.nr.418/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që t'i njihet e drejta e përvojës së punës në OSCE, për periudhën kohore 18.01.2000 deri 31.12.2001.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.05.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa me datë 20.05.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen ne ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses A.nr.418/2021 me numër protokollit 2393/2021 e datës 14.05.2021 me shkresat e bashkangjitura 1/8; E-mailin e datës 20.04.2021 nga ankuesja; E-mailin e datës 19.04.2021 nga ankuesja; E-mailin e datës 19.04.2021 nga ankuesja; E-mailin e datës 05.03.2020 nga ankuesja për E-mailin e datës 02.05.2019 nga ankuesja për Shkresë nga OSBE e datës 08.06.2015; Vendimin Nr.06/29 i datës 15.05.2015 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kontratë Pune e datës 18.09.2006; Ndryshimi i Aktit të Emërimit i datës 03.12.2014; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.05.2021 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 20.05.2021.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Aktin e Emërimit të datës 03.12.2014 është konstatuar së ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare e Lartë për Arkivimin e Dokumenteve", pranë Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Ankuesja me datë 05.03.2021 ka bërë kërkesë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me njohjen e përvojës së punës në OSCE, për periudhën kohore 18.01.2000 deri 31.12.2001. Lidhur me këtë çështje, Divizioni për Burime Njerëzore pranë MPB-së, i është drejtuar ankueses me kërkesë që t'i sjell dëshmitë lidhur me kontributet e paguara sipas Vendimit Nr. 06/29 të datës 15.05.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ankuesja e pakënaqur me mos njohjen e përvojës së punës për periudhën 18.01.2000 deri 31.12.2001, me datë 14.05.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në provat e lëndës si dhe gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, konstaton se me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave të dëshmimit të përvojës së punës respektivisht me qëllim të pagesës së shtesës mbi përvojën e punës, Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 15.05.2015 ka nxjerr Vendim me Nr. 06/29 me të cilin në pikën 2 ka përcaktuar se: "Njohja e përvojës së punës pas Qershorit 1999 dëshmohet përmes njërit nga këto dëshmi: 2.5. Dëshmisë mbi përvojën e punës të lëshuar nga Organizatat Qeveritare dhe Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare të shoqëruara me dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent". Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se ankuesja për njohjen e përvojës së punës në OSCE është dashur të sjell si dëshmi kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent, siç përcaktohet me Vendimin Nr.06/29 të datës 15.05.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, andaj në mungesë të dëshmimeve përkatëse, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për njohjen e përvojës së punës për periudhën 18.01.2000 deri 31.12.2001, për qëllime kompensimi material, është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.418/2021

Avdyr BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

